



# GJUHA BLU (GB)

## Çka është sëmundja gjuha blu (GB)?

Sëmundja gjuha blu është sëmundje virale jokontagjioze e kafshëve ripërtytuese shtëpiake dhe te egra, prej të cilave (më se shumti sëmuren dhentë por vërehet edhe tek gjedhi, dhite, buallicat, antilopat, drerët, kaprojt dhe devetë), e cila transmetohet nëpërmjet insekteve-mushkonjave të llojit CULICIDES.

Virusi që e shkakton sëmundjen i takon familjes REOVIRIDAE nga e cila egzistojnë 24 stereotipe me virulencë të ndryshme.

Sëmundja manifestohet në forma të ndryshme tek llojet e ndryshme të kafshëve, por në formën më të rëndë paraqitet tek dhentë tek te cilat shkakton kasheksi, ngadalësim të rritjes së leshit dhe deri në ngordhje. Në rastet më të rënda Morbiditeti mund të arrijë deri 100%, kurse Mortaliteti në varësi të stereotipi të virusit dhe kushteve tjera shkon 2-30% dhe në raste tjera edhe deri 70%.

Tek gjedhet egziston një nivel më i lartë i prekshmërisë se sa tek dhentë, ndërsa pasqyra klinike është variabile ku rrol të vecantë ka stereotipi viral. Virusit të sëmundjes gjuha blu i cili në këtë periudhë kohe qarkullon në Evropën veriore, ka rëndësi epidemiologjike veçanërisht për formën klinike të kësaj sëmundjeje tek gjedhi.

Në zonat endemike sëmundja sjellë dëme të mëdha ekonomike për arsye të restriksionit tregtar dhe harxhimeve për implementimin e programeve për parandalimin, monitorimin, kontrollimin dhe vaksinimin kundër kësaj sëmundjeje.

Sëmundja Gjuha Blu është në listën e Organizatës botërore për shëndetin e kafshëve (OIE) të sëmundjeve që i nënshtrohen raportimit të detyrueshëm.



## Përhapja

Sëmundja është prezente në të gjitha vendet ku janë prezent vektorët-mushkonjat e llojit Culicide (Evropë, Azi, Afrike, Australi, Amerikë) të cilat mund të shumohen dhe mbijetojnë në kushte të favorshme klimatike dhe atmosferike bile edhe gjatë dimrit.

Gjinia Culicide përfshin mbi 1000 shtame virale por vetëm 20 prej tyre kane aftësi ta shkaktojnë sëmundjen Gjuha blu.

Dhentë që ruhen (mbarështohen) në zonat endemike mund të jenë rezistente ndaj kesaj semundjeje kurse dhentë të cilët futen në zonat endemike ose kur virusi futet ne zonat e lira nëpërmjet vektoreve sidomos gjatë stinës se verës kur ka shumë lagështi.

## Si përçohet sëmundja?

Mënyra e vetme e transmetimit te sëmundjes është nëpërmjet vektoreve-mushkonjave te cilët duke pickuar kafshët transmetojnë sëmundjen (virusin) nga njëra kafshë te tjetra. Semundja nuk transmetohet nga njera kafshe te tjetra.

Kafshët e infektuara kanë rrol të veçantë në mbajtjen e virusit (rezervuare të sëmundjes) sidomos gjedhët tek të cilët manifestimi klinik është pak më e zbehtë.

Poashtu virusi është i pranishëm edhe në spermën e Demave dhe Dëshëve sëmundja mund të transmetohet edhe nëpërmjet ndërzimit, por kjo formë transmetimi nuk është shumë e rëndësishme.

Sëmundja nuk transmetohet nëpërmjet kontaktit nga njëra kafshë tek tjetra apo nëpërmjet konsumimit të qumshtit.



## Cili është rreziku për shëndetin publik lidhur me këtë Sëmundje?

Nga kjo sëmundje nuk ka rrezik për shëndetin publik të njerëzve. Njeriu nuk preket.

Pasqyra klinike tek gjedhet ndryshon nga lloji i virusit ndërsa tek dhitë paraqitet në formë shumë të lehtë apo edhe nuk hetohet.



## Cilat janë shenjat klinike të sëmundjes? Si diagnostikohet sëmundja?

Tek dhentë mund të hasen këto shenja klinike:

Dyshimi për sëmundjen Gjuha blu bazohet mbi shenjat klinike, prezencën e vektorëve si dhe analizat laboratorike.

- Temperaturë (ethe)
- Diarre me gjak dhe plagë në kavitetin e gojës dhe hundës
- Salivacion, dhe rrjedhje nga hundët, enjtje e buzeve, gjuhës dhe nofullës.
- Çalim dhe veshtiresi në levizje
- Dobësi, gjendje depresive dhe humbje në peshë
- Diarre, vjellje, frymëmarrje e veshtirësuar
- Gjuha me ngjyrë të kaltër (haset pak me rrallë)
- Aborte

Ngadalësim i rritjes së leshit, ulje e cilësisë dhe rënie e tij nga trupi.



## **Çka duhet ndërmarrë për ta parandaluar dhe kontrolluar këtë sëmundje?**

### **Parandalimi dhe masat kontrolluese**

Ne zonat endemike bëhet monitorimi i kafshëve të dyshimta, meren mostra nga kopetë sentinele (të dyshimta) dhe zbatohen analiza laboratorike.

Paralelisht duhet të bëhet mbikqyrje aktive për tu vërtetuar lokacioni, distribuimi dhe prevalenca e vektorëve.

Bëhet identifikimi dhe mbikqyrja e kafshëve që shfaqin shenja klinike.

Ndalohet dhe kontrollohet levizja e kafsheve gjatë periudhës së aktivitetit të vektorëve.

Behet vaksinimi.

Dezinfektimi dhe Dezinsektimi i zonave ku gravitojnë kafshët.

\*Vaksinimi shërben si masë themelore për parandalimin e transmetimit të sëmundjes nga kafsha bujtëse tek vektori si dhe për zvoglimin e humbjeve.

\*Duhet të përdoren vaksina apo stafate për secilin stereotip viral.



## FAKTE KYÇE

- Gjuha blu per herë të parë është hasur në Afrikën jugore si sëmundje endemike e ripërtpësve të egër.
  - Epidemia e Gjuhës blu ne vitin 1943 në QIPRO në disa tufa shkaktoi 60-70% humbje
  - Epidemia e Gjuhës blu në Spanjë dhe Portugali në viti 1956 nga një shtamë shumë virulent shkaktoi ngordhjen e 46000 dhenve në Portugali dhe 133000 në Spanjë.
  - Rasti i parë i sëmundjes ka qenë në Holandë në gusht të vitit 2006 si lokaliteti më verior ku sëmundja është diagnostikuar.
- Epidemitë e hasura edhe në disa vende tjera Verio-Evropjane karakterizohen nga faktorët e njejtë epidemiologjik, Sidomos gjerësia gjeografike veriore përhapja e insekt-vektorëve që janë të aftë të mbijetojnë edhe në kushte dimërore si dhe prezenca e kafshëve potencialisht te prekshme.